

UDHËZIM
Nr.9293/1, datë 8.6.2011

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR KARTËN E MEMORIES SË TAHOGRAFIT DIGJITAL

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.10 211, datë 23.12.2009 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.9, datë 11.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e funksionimit dhe burimet e financimit të sistemit të tahogرافit digjital në Shqipëri”, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministri i Financave

UDHËZOJNË:

Neni 1
Qëllimi

1. Kartat e memories së tahogرافit digjital lëshohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për drejtuesit e mjeteve, të përfshirë në ligjin nr.9514, datë 18.4.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen europiane “Për punën e ekuipazheve të mjeteve të përfshira në transportin ndërkombëtar rrugor (AETR) dhe në protokollin e nënshkrimit e në amendamentin nr.4 të saj”” dhe, ose të përfshirë në rregulloren “Për organizimin e kohës së punës së personave, që kryejnë transport rrugor, për orët e drejtuesve të mjeteve dhe pajisjet e regjistrimit”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1243, datë 10.9.2008.

Neni 2

Tarifat e lëshimit të kartave të memories për tahogرافin digjital

1. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për drejtuesit e mjetit të përmendur në pikën 1 të nenit 1, është në shumën 100 euro.
2. Tarifa e pagesës për kartën e tahogرافit digjital për kompanitë e transportit rrugor dhe ofiçinave të tahogرافit është në shumën 100 euro.
3. Karta e tahogرافit digjital për personat e kontrollit dhe/ose grupet e kontrollit lëshohet pa pagesë.
4. Tarifa për rinovimin, zëvendësimin dhe ndryshimin e kartës së tahogرافit digjital, të përmendura në pikat 1 dhe 2, është e njëjtë me tarifën e lëshimit për herë të parë.
5. Rinovimi, zëvendësimi dhe ndryshimi i kartës së tahogرافit digjital, të përmendura në pikën 3 kryhet pa pagesë.

Neni 3

Në tarifat e përcaktuara në këtë udhëzim është e përfshirë TVSH-ja.
Udhëzimi hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE
DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

MINISTRI I FINANCEVE
Ridvan Bode